

VENDIM
Nr. 521, datë 1.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 692, DATË 5.10.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
'KRITERET PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË SË UDHËRRËFYESIT TURISTIK, DETYRAT, PËRGJEGJËSITË
DHE KODIN E ETIKËS SË TYRE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 692, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3, emërtesa: "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" zëvendësohet me fjalët: "... ministria përgjegjëse për turizmin ...".

2. Në rregulloren "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre", bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 2, shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) "Aplikim elektronik", nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, ku të mundësohet aplikimi për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik dhe dorëzimi i dokumenteve që shoqërojnë kërkesën."

b) Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për t'u pajisur me certifikatën e udhërrëfyesit turistik, aplikuesi duhet të plotësojë formularin e aplikimit, i cili duhet të përmbajë:"

ii. Shkronja "ç", e pikës 2, shfuqizohet.

iii. Shkronja "a", e pikës 3, shfuqizohet.

iv. Pas shkronjës "dh", të pikës 3, shtohet shkronja "e", me këtë përmbajtje:

"e) Fotografinë për dokument të aplikuesit në format elektronik."

c) Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Pika 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Udhërrëfyesi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës së tij, aplikon nëpërmjet formularit të aplikimit, me të njëjtat të dhëna, të parashikuara në pikën 2, të nenit 5."

ii. Shkronja "a", e pikës 2, shfuqizohet.

iii. Pas shkronjës "d", të pikës 2, shtohet shkronja "dh", me këtë përmbajtje:

"dh) Fotografinë për dokument të aplikuesit në format elektronik."

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2021.

KRYEMINISTËR
Edi Rama